

VENDIM
Nr. 245, datë 24.4.2019

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE E TË SHITESAVE MBI PAGË TË NËPUNËSVE DHE PUNONJËSVE ADMINISTRATIVË NË AGJENCINË SHETËTËRORE TË KADASTRËS

(Ndryshuar me vendimin nr. 24, datë 13.1.2022)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave e të shtesave mbi pagë për nëpunësit e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

2. Elementet e pagës për secilën kategori, të përcaktuara në lidhjet nr. 1 e nr. 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi, si dhe vlerat për secilin element, janë të njëjta me ato të miratuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në institucionet e administratës shtetërore.

3. Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, janë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni”, në drejtoritë vendore dhe zyrat vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, janë sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Pagat dhe shtesat mbi pagë të punonjësve administrativë në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës janë sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve të administratës shtetërore.

6. Vendimi nr.217, datë 20.3.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e nivelit të pagave të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, shfuqizohet.

7. Emërtesat “Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale”, përmendur në shkronjën “a”, të pikës 1/3, dhe “Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike”, përmendur në shkronjën “b”, të pikës 1/3, dhe në pikat 9/2 e 12/3 dhe lidhjet 6/2 e 9/3, të vendimit nr.187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit”, të ndryshuar, shfuqizohen.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.111/2018, “Për kadastrën”, si dhe nga buxheti i miratuar për vitin 2019, në ligjin e buxhetit për Agjencinë e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale dhe Agjencinë e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike. Efektet financiare fillojnë nga momenti i emërimit, transferimit të nëpunësve/punonjësve në pozicionet e reja të punës, por jo më vonë se 6 muaj, nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Lidhja nr. 1

Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni” në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës
(ndryshuar me vendimin nr. 24, datë 13.1.2022)

Pozicioni	Kategoria	Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimit në pozicionin përkatës të punës paga e grupit	Shtesa për kushte pune
Titullar i institucionit	I-a	1	20.000
Zëvendëstitullar i institucionit, Drejtor njësie	I-b	1	20.000
Drejtor drejtorie	II-b	1	20.000
Përgjegjës sektori	III-a	1	18.000
Përgjegjës sektori që lidhen me procesin e informatizimit	III-a	1	20.000
Koordinator	III-a/1	1	18.000
Specialist në pozicionet që lidhen me procesin e informatizimit	III-b	1 ose 2	20.000
	IV-a	1 ose 2 ose 3	
Specialist	III-b	1 ose 2	18.000
	IV-a	1 ose 2 ose 3	

Lidhja nr. 2

Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni” në drejtoritë vendore dhe zyrat vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës

Pozicioni	Kategoria	Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimit në pozicionin përkatës të punës paga e grupit	Shtesa për kushte pune
Titullar i drejtorive vendore të kategorisë së parë	III-a	1	20.000
Titullar i drejtorive vendore të kategorisë së dytë	III-a/1	1	18.000
Zëvendëstitullar i drejtorive	III-a/1	1	18.000

vendore të kategorisë së parë			
Zëvendësitullar i drejtorive vendore të kategorisë së dytë	III-b	1	18.000
Drejtor drejtorie në drejtoritë vendore të kategorisë së parë	III-a/1	1	18.000
Drejtor drejtorie në drejtoritë vendore të kategorisë së dytë	III-b	1	18.000
Përgjegjës sektori në drejtoritë vendore të kategorisë së parë	III-b	1	18.000
Përgjegjës sektori në drejtoritë vendore të kategorisë së dytë	IV-a	1	18.000
Titullar i zyrës vendore	IV-a	1	18.000
Specialist në drejtoritë vendore të kategorisë së parë	IV-a	1 ose 2 ose 3	18.000
Specialist në drejtoritë vendore të kategorisë së dytë, Specialist në zyrat vendore	IV-b	1 ose 2 ose 3	18.000

Kategorizimi i drejtorive vendore është si vijon:

- Kategoria e parë: drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës, Elbasan, Tiranë Veri, Tiranë Jug, Tirana Rurale 1, Tirana Rurale 2, Vlorë, Fier, Kamzë-Vorë, Shkodër, Korçë, Lezhë, Berat, Kavajë, Gjirokastrë, Krujë, Lushnjë, Pogradec, Sarandë, Dibër, Kukës dhe zonat e stimuluar.

- Kategoria e dytë: drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kuçovë dhe Tepelenë.